


Vizioni

Ta bëjmë Kolonjën për Kolonjarët dhe për të tjerët!

Kolonja rikthen dëshirën e komunitetit për të punuar dhe investuar në zonën e tyre, falë zhvillimit lokal dinamik dhe të qëndrueshëm. Kolonja përdor burimet natyrore në mënyrë të qëndrueshme, shfrytëzon infrastrukturën rurale të përmirësuar dhe promovon dhe ruan biodiversitetin e pasur dhe trashëgiminë kulturore historike të pashembullt në pasurinë e vet.



Kontakt:

+355 69 479 9009

lagkolonja6@gmail.com

Sheshi Rilindja Godina e ish Komitetit të Partisë,
Ersekë, Shqipëri

Kjo fletëpalosje është prodhuar nga Rrjeti Shqiptar për Zhvillim Rural, në rolin e nënkontraktorit të projektit "Fuqizimi i Grave në zonat Rurale dhe Turizmi" së bashku me UN Women Albania, të financuar nga Qeveria Italiane dhe në partneritet me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

TA BËJMË KOLONJËN PËR KOLONJARËT DHE TË TJERËT!



Zona “Leader”

Grupi Vendor i Veprimit “Kolonja e Gjelbër” vepron në territorin e Bashkisë Kolonjë, me një shtrirje prej 864 km². Zona Leader mbulon gjithë territorin e bashkisë Kolonjë: njësitë administrative Ersekë, Qendër Ersekë, Leskovik, Qendër Leskovik, Mollas, Çlirim, Novoselë dhe Barmash. Kjo zonë ka dy zona urbane, Ersekë dhe Leskovik, si dhe 76 fshatra.

Kolonja është e pasur me burime të shumta natyrore, me njerëz punëtorë e bujarë, me trashëgimi të pasur kulturore. Gjithçka çfarë duhet për të nxitur një zhvillim të qëndrueshëm vendor dhe mirëqenie për popullsinë vendase.

Popullsia

Në zonën “Leader” të GVV “Kolonja e Gjelbër” jetojnë rreth 11,070 banorë të shpërndarë në tetë njësitë administrative. Erseka ka numrin më të lartë të popullsisë, pasuar nga Qendër Erseka, dhe më pas nga Leskoviku.

Pavarësisht potencialeve zhvillimore të zonës, popullsia është tkurrur nga viti në vit. Disa fshatra nuk kanë banorë të përhershëm dhe popullohen vetëm gjatë stinës së verës. Njësia administrative Çlirim, Novoselë dhe Qendër Leskovik kanë popullsi të ulët, që nuk arrijnë as 500 banorë.

- ▶ GVV “Kolonja e Gjelbër” u krijua fillimisht në vitet 2017-2018 në kuadër të projektit të shërbimeve mjedisore, me mbështetjen financiare të Bankës Botërore dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.
- ▶ Ndër vite GVV “Kolonja e Gjelbër” ka qenë aktive në shkëmbime dhe rrjetëzime me aktorë të ndryshëm brenda dhe jashtë vendit. Kolonja e Gjelbër ka qenë aktive në koalicionin “Rajoni i Gjelbër” në qarkun e Korçës; ka marrë pjesë në vizitë studimore në zonën e Kelmendit, ka shkëmbyer përvojë me GVV-të në Kosovë, si dhe ka qenë pjesëmarrëse në vizita studimore për t’u ekspozuar me përvoja të sukseshme të GVV-ve në Austri.
- ▶ Falë mbështetjes së projektit “Fuqizimi i Grave në zonat Rurale dhe Turizmi”, GVV filloi një proces intensiv të gjallërimit të territorit dhe mobilizimit të komunitetit për rishikimin e partneritetit vendor dhe për hartimin e Strategjisë së Zhvillimit Vendor të zonës me pjesëmarrje dhe gjithëpërfshirëse, në frymën e parimeve të metodës “Leader”.
- ▶ Kjo mbështetje harmonizoi GVV me Ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Grupeve Vendore të Veprimit”, me qëllimin për të kontribuar për një zhvillim të qëndrueshëm koheziv social ekonomik në komunitetet vendore të mbuluara nga zona “Leader”.
- ▶ Në 2024, GVV Kolonja e Gjelbër është e autorizuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për të funksionuar si Grup Vendor Veprimi – një strukturë partneriteti e lejueshme për mbështetje financiare nga masa Leader e programit IPARD III.

¹ Ky projekt zbatohet nga Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural në rolin e nënkotraktorit të UN Women Albania, financuar nga Qeveria Italiane dhe në partneritet me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.



GVV “Kolonja e Gjelbër” është një strukturë partneriteti e aktorëve vendorë me përfaqësues nga tre sektorë (autoritete publike, operatorë ekonomik dhe social). Anëtarët e GVV përfaqësojnë gjithë territorin e zonës Leader dhe grupet e interesit në zonë, duke respektuar barazinë territoriale, gjinore dhe të moshës.

Asambleja e Përgjithshme përbëhet prej 26 anëtarësh. Bordi përbëhet nga 9 anëtarë të zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme, ku secili prej sektorëve përfaqësohet nga 3 anëtarë. 4 anëtarë të Bordit janë gra, dhe 2 të rinj, poshtë moshës 35 vjeç. Të gjithë anëtarët e bordit janë rezidentë në territorin e GVV-së.

